

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **K.K. SKENDERAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **643-26-6985-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **026 - Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve, shkollave dhe institucioneve tjera vartëse në kuadër të komunës së Skenderajt**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	BIOVET DDD SH.P.K.
NUI	812365923
Adresa	Rr. Avni Saraqi nr. 71
Vendi	Vushtrri
Kodi postar	42000
Numri Telefonit	044/147-297
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Safet Osmani
Adresa elektronike	safetosmani2025@hotmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	20.09.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

026 - Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve, shkollave dhe institucioneve tjera vartëse në kuadër të komunës së Skenderajt

AK ka publikuar NJK (njoftimin për kontratë) në e-prokurim me datën: 21.08.2026

AK ka planifikuar hapjen me datë: 14.09.2026

Me datën: 30.08.2026 kemi kërkuar sqarime sipas nenit 53 të LPP nga AK e cila është sqaruar pa u mbështetur në dispozita ligjore të LPP-se dhe është enëshkelje të nenit 7 dhe 51 të LPP-se.

NE si OE kemi parashtruar KpR pran AK në e-prokurim me datë: 08.09.2026

AK – ZPP me datën 16.09.2026 nxjerr vendim duke na refuzuar KpR në shkeje të nenit 108/A par. 8 dhe 12 të LPP-se, Duke shkëlur afatin ligjor për nxjerrje të vendimit dhe duke mos argumentuar sipas LPP-se dhe duke kufizuar konkurrencen???/...

Ankesa në OSHP me dt. 20.09.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

AK ka nxjerr me date 16.09.2026, pertej afatit ligjore pasi qe ne kemi parashtruar KpR me date 08.09.2026, duke refuzuar dhe duke mos shkruar askund ne vendim emrin tone dhe as nuk eshte nenshkruar nga persona koompetent kjo ben te pavlefshem kete akte juridik sipas LPPA. te njejtin e gjeni ne e-prokurim ngarkaur nga AK.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

K.K. SKENDERAJ - shkelur këto Dispozita Ligjore të LPP-së, si në vijim:

Neni 1 të LPP-së

Neni 2 të LPP-së

Neni 6 të LPP-së

Neni 7 të LPP-së

Neni 24 te LPP-së

Neni 51 te LPP-së

Neni 53 te LPP-së

Neni 56 par. 2.1 te LPP-së

Neni 64 te LPP-së

. Neni 66 te LPP-së

. Neni 69 te LPP-së

. Neni 70 te LPP-së

. Neni 108/A te LPP-se

. Nenin 109 te LPP-se.

Neni 17.12; 17.15; 17.17 të Rreg. Nr. 002/2024 per PP – version i konsoliduar

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në mbështetje të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ne, Operatori Ekonomik Biovet DDD SHPK., paraqesim këtë KpR kundër NJK dhe DT ne KK Skenderaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "**026 - Dezinsektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve, shkollave dhe institucioneve tjera vartëse në kuadër të komunës së Skenderajt**", me numër të prokurimit **643-26-6985-2-2-1**

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit për aktivitetin e lartcekur, ndërsa ne, pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit, kemi konstatuar se disa nga kriteret e kualifikimit dhe kërkesat teknike nuk janë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, pasi janë kufizuese, joproporcionale dhe cenojnë parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Për këtë arsye, më 08.09.2026, po paraqesim Kërkesë për Rishqyrtim, duke kërkuar korrigjimin e pikave të kontestuara të Dosjes së Tenderit.

PRETENDIMET ANKIMORE

Me qëllim të paraqitjes së plotë të bazës faktike dhe juridike të kësaj ankese, më poshtë paraqesim secilin prej pretendimeve tona ankimore, ashtu siç janë ngritur fillimisht në Kërkesën për Rishqyrtim.

Pas paraqitjes së secilit pretendim dhe përgjigjes përkatëse të Autoritetit Kontraktues, ne do të paraqesim analizën dhe arsyetimin tonë juridik, duke argumentuar pse konsiderojmë se DT dhe NJK - kriteret e përzgjedhjes nga Autoritetit Kontraktues janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, parimet themelore të prokurimit publik dhe praktikën e Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Kerkesa 3. Operatori ekonomik duhet te angazhoj staf te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore si mëposhtë

a) Një epidemiolog me certifikatë universitare, dhe licensë pune valide.

b) Një (1) Bachelor i Shkencave të mjekësisë sanitare ose teknik sanitarë.

d) Së paku 3 punëtorë profesional me eksperiencë në lëmine e DDD-së- te deshmohet **me Certifikatë Aplikues të Biocideve** dhe Lëndëve D.D.D Kontrata pune, të bashkangjitet licenca në ofrimin e kurseve të formimit Profesional për Organizaten që ka lëshuar këto Certifikata.

f). Një Teknik Menaxhimi i Emergjencave të deshmohet me Diplomë

Dëshmia 3. Lista e stafit profesional duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe vulosur nga OE, dhe duhet t'i përmbaj këto informata Emrin, Mbiemrin, Profesionin, Eksperienca (përvojën e punës) dhe pozitën në kompani. Për pikën a) Të deshmohet me certifikat universitare, licensë pune valide, referencë minimum dy (2) vite provojë pune në shërbime të DDD-se, deshmi mbi përvojën e punës, CV-ja dhe Kontrata e punës ,si dhe vendim për caktimin të menaxherit. Për pikën b). Dëshmitë e diplomave dhe licenca e punës valide, minimum Tre (3) vite përvojë pune në shërbime të DDD-se, deshmi mbi përvojën e punës, kontratë dhe Referencë.

Për pikën d). Dëshmitë e certifikatave të trajnimit. Kontrata pune, min tre (3) vite përvojë pune në shërbimet e DDD-se, deshmi mbi përvojën e punës, të bashkangjitet licenca në ofrimin e kurseve të formimit Profesional për Organizaten që ka lëshuar këto Certifikata.

Për pikën f). Të deshmohet me diplomë, kontratë dhe Referencë, minimum dy(2) vite përvojë pune në Shërbime të DDD-se, deshmi mbi përvojën e punës, kontratë dhe Referencë.

Arsyetim Kërkesa nr. 3 është e pajustificuar dhe joproportionale, pasi kërkohet që operatori ekonomik të ketë një EPIDEMIOLOG . Për realizimin e shërbimeve DDD, përgjegjësitë organizative dhe mbikëqyrëse mbulohen nga stafi profesional i kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe nga menaxheri i kontratës, i cili udhëheq dhe koordinon realizimin e kontratës.

Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar nevojën për një ekspert të veçantë si EPIDEMIOLOG, duke perjashtuar, KUFIZUAR, Diskriminuar “ MJEKUN VETERINAR BIOLOGUN DHE KIMISTIN, pasi që të gjithë këto profesione mund të LICENCOHET nga MBPZHR me leje të shërbimeve të DDD-se, prandaj kërkesa që për natyrën e shërbimeve të DDD ku AK – ka kërkuar vetëm Epidemiolog përben kufizim dhe diskriminim për faktin se të gjithë ata OE të cilët janë të Licencuar nga MBPZHR me lejë për shërbim të DDD kanë përvojën dhe listën e kontratave dhe mund të ekzekutojnë këto shërbime ju pa mundësi të TENDEROJN në këtë AP.

Prandaj kjo kërkesë paraqet një kriter shtesë të panevojshëm që rëndon pa arsye kriteret e kualifikimit dhe kufizon konkurrencën, në kundërshtim me nenin 51 paragrafi 3 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik. Kërkohet që Kërkesa nr. 3 të hiqet nga Dosja e Tenderit, pasi përgjegjësitë për organizimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të kontratës duhet të lejohet edhe Mjeku veterinar, Biologu dhe Kimisti I Diplomuar sepse kështu si është edhe “Epidemiologu” duke e bërë këtë kërkesë të panevojshme dhe joproportionale, duke diskriminuar dhe kufizuar disa OE të tenderojnë, duke shkelur efikasitetin dhe vlerën për para si parim kryesor të prokurimit.

Andaj Lusim AK ti aprovoj kerkesn tone dhe t ekorigjoj DT duke ju lejuar OE te interesuar te cilet jane Mjek Veterinar, Biolog dhe Kimist te diplomuar apo/edhe ekolog te pranohet per natyren e ketyre sherbimeve te DDD. PROVE: fakti qe MBPZHR I licencon te gjith eketo profesiona me leje per sherbime te DDD-se ateher eky kufizim nga AK ne DT per pranim vetem te Epidemiologu eshte kufizim dhe shkelje e nenit 7 dhe 51 te LPP-se.

Ne nuk pajtohemi me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues pse ka pranuar se kriteri fillestar ishte i pajustificuar dhe ka zgjeruar profilin profesional duke përfshirë vetem **Epidemiologun**, ai ka vazhduar të përjashtojë pa asnjë arsyetim objektiv profilet e **Biologut, Mjekut Vetirnar, Ekologut dhe Kimist te diplomuar**, të cilat janë po ashtu profile profesionale të lidhura drejtpërdrejt me veprimtarinë e Dezinsektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit (DDD).

Autoritetit Kontraktues rezulton se ai ka pranuar se objektivi i kriterit – sigurimi i një niveli të lartë profesional në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të kontratës – mund të arrihet edhe duke pranuar profile të tjera profesionale ekuivalente, të cilat legjislacioni sektorial i njeh si të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë DDD. Megjithatë, përkundër këtij konstatimi, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim pse ka pranuar vetëm profilin e Epidemiologut, ndërsa ka vazhduar të përjashtojë **Biologut, Mjekut Vetirnar, Ekologut dhe Kimist te diplomuar**.

Ky veprim është kontradiktor, pasi vetë Autoriteti Kontraktues pranon se kriteri nuk duhet të kufizohet vetëm në një profil profesional, por pa asnjë analizë teknike apo ligjore vendos të kufizohet vetëm në një profile, duke mos shpjeguar pse profilet e tjera profesionale të njohura nga legjislacioni sektorial nuk konsiderohen të përshtatshme për të ushtruar funksionin e menaxherit të kontratës. Për më tepër, Ligji Nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve, si dhe kushtet zyrtare për pajisje me licencë për ushtrimin e veprimtarisë DDD, njohin **Biologut, Mjekut Vetirnar, Ekologut dhe Kimist te diplomuar**, si profil profesional të pranueshëm për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Në të njëjtën mënyrë, edhe profili i Veterinarit është i lidhur drejtpërdrejt me kontrollin e organizmave të dëmshëm, mbrojtjen e shëndetit publik dhe zbatimin e masave sanitare. Për rrjedhojë, nuk ekziston asnjë bazë objektive apo ligjore që këto profile të përjashtohen nga ushtrimi i funksionit të mjektu veterinar.

ANALIZA DHE ARSYETIMI YNË LIDHUR ME PRETENDIMI NR. 3

Ne nuk pajtohemi me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues, pasi ai nuk është i mbështetur në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe nuk demonstroi se kërkesa për **Certifikatë Aplikues të Biocideve**

Kjo certifikatë është objektivist e jo e domosdoshme dhe proporcionale me objektin e kësaj kontrate, për faktin se AK ka kërkuar **lejen e importit për produktet biocide të lëshuar nga MMPH**, dhe për faktin se është e keqkruar kjo leje ather pa i plotësuar kushtet OE nuk mund të licencohet dhe marr për bazë natyrën e shërbimeve të DDD sigurisht duhet të kërkohej Certifikatë për SHERBIME TË DDD-se, dhe jo për aplikues të biocideve sepse mjafton leja për produkte të biocideve dhe duhet të pranohen edhe detyrimisht të Kërkohen Edhe “Certifikatë për shërbime të DDD” sepse aktiviteti i prokurimit është shërbime të DDD dhe mungesa e stafit të certifikuar për shërbime të DDD përben shkelje të nenit 7 dhe 52 të LPP-se.

Autoriteti Kontraktues arsyeton se objekti i kontratës përfshin përdorimin e produkteve biocide dhe, për këtë arsye, ekziston nevoja për zbatimin e masave të sigurisë

. Ne nuk e kontestojmë faktin se gjatë realizimit të shërbimeve DDD duhet të respektohen të gjitha dispozitat ligjore që rregullojnë sigurinë dhe shërbimet e DDD. Megjithatë, çështja që kemi ngritur nuk ka të bëjë me zbatimin e këtyre masave, por me faktin se Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar pse një ekspert i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë me minimum pesë (5) vite përvojë duhet të jetë kriteri paraprak i kualifikimit për këtë aktivitet të prokurimit. Në vendimin e tij, Autoriteti Kontraktues kufizohet në përshkrimin e përgjithshëm të rreziqeve që mund të paraqiten gjatë realizimit të kontratës dhe në detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për sigurinë dhe shëndetin në punë. Mirëpo, ai nuk ka paraqitur asnjë analizë konkrete që të dëshmojë se vetëm një operator ekonomik që disponon një ekspert të tillë me pesë (5) vite përvojë është në gjendje ta realizojë këtë kontratë.

Po ashtu, nuk është arsyetuar pse stafi profesional i kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe menaxheri i kontratës nuk janë të mjaftueshëm për organizimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të kontratës. Sipas nenit 51 të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë dëshmi lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale vetëm në masën që ato janë proporcionale dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Gjithashtu, neni 69 kërkon që kriteret e aftësisë teknike dhe profesionale të jenë objektive, të arsyeshme dhe të nevojshme për realizimin e kontratës.

Po ashtu, neni 7 i Ligjit për Prokurimin Publik obligon Autoritetin Kontraktues të trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe të mos vendosë kërkesa që kufizojnë ose eliminojnë konkurrencën pa një arsyetim objektiv. Në veçanti, paragrafi 3 i këtij neni ndalon vendosjen e kërkesave ose kritereve të përzgjedhjes që favorizojnë ose diskriminojnë operatorët ekonomikë, ndërsa paragrafi 6 obligon Autoritetin Kontraktues të eliminojë kriteret dhe kërkesat diskriminuese dhe të sigurojë pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë.

Po ashtu, neni 7 i Ligjit për Prokurimin Publik obligon Autoritetin Kontraktues të trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe të mos vendosë kërkesa që kufizojnë ose eliminojnë konkurrencën pa një arsyetim objektiv.

Në veçanti, paragrafi 3 i këtij neni ndalon vendosjen e kërkesave ose kritereve të përzgjedhjes që favorizojnë ose diskriminojnë operatorët ekonomikë, ndërsa paragrafi 6 obligon Autoritetin Kontraktues të eliminojë kriteret dhe kërkesat diskriminuese dhe të sigurojë pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka provuar se kërkesa staf me certifikat te DDD është e domosdoshme për realizimin e kontratës. Përkundrazi, ai vetëm ka kërkuar certifikat për aplikues të biocidëve?!.....

Këto obligime ekzistojnë për çdo operator ekonomik pavarësisht nëse një kërkesë e tillë është përfshirë ose jo në Dosjen e Tenderit dhe nuk mund të përdoren si bazë për vendosjen e një kriteri shtesë të kualifikimit pa një arsyetim të veçantë.

Prandaj me fjale tjera per keto dy pretendim ton per epidemiolog dhe certifikat per sherbime te DDD, te aprovohen KpR dhe te lejohet edhe Mjeku vetirnar, Ekologu, Biologu dhe Kimisti I diplomuar, ndersa per ne vend te Certifikates per aplikues t e biocidëve te kerkohet: “Certifikat per sherbime te DDD” sespe kjo certikat eshte proporcional ne raport te drejperdrejt m enatyren e sherbiemve dhe qellimin eprokuirmit, kurse Leja per importine prodokuteve Biocide eshte kerkese qe secili OE I cili ofron sherbime te tila te jete I Licencuar nga MMPH dhe eshte kerkese e drejt dhe proporcional me natyren e sherbimeve.

ANALIZA DHE ARSYETIMI YNË LIDHUR ME PRETENDIMI NR. 2

Kapaciteti teknik dhe profesional:: neni 9.1 & 9.2 te FDT-se janë si e vijim:

-

Kerkesa 2. OE duhet të ketë Certifikatë a)ISO 9001 2015 b)ISO 14001 2015 c)ISO 45001 2018

d) EN 16636 2015- Cepa certified

Dëshmia 2.Oe Duhet të ofroj certifikatat valide.

Baza Ligjore ne LPP - Neni 66.2 te LPP-së dhe neni 26.5

Ne me ane te kësaj shkrese kërkojmë sqarim nga AK lidhur me këto ISO Standarde **EN 16636 2015- Cepa certified** Pse eshte i nevojshem ky standard per Sherbime DDD-se. **Një detaj i rëndësishëm:** EN 16636 nuk është standard për “pastrim” në përgjithësi dhe nuk mbulon mbrojtjen e kulturave bujqësore apo pastrimin/dezinfectimin rutinë.

A keni verifikuar sa kompani ne Kosove e posedojn kete ISO standard dhe cilat jane ato ??!.....

Ky Standarde perben Kufizim dhe favorizim andaj kerkojm te largohet dhe te hapet konkurrenca dhe transparenca sepse mjaftojn ISO standardet tjera dhe Leja nga MPBZHR-ja dhe leja nga MMPH te cilat jane kerkuar ne DT dhe jane te Arsyeshem por kjo perben kufizim sespe iu pamundeson me shume 90% te kompanive qe ofrojn sherbime te DDD qe te tendrojn:

Ky Standarde perben Kufizim dhe favorizim andaj kerkojm te largohet dhe te hapet konkurrenca dhe transparenca sepse mjaftojn ISO standardet tjera dhe Leja nga MPBZHR-ja dhe leja nga MMPH te cilat jane kerkuar ne DT dhe jane te Arsyeshem por kjo perben kufizim sespe iu pamundeson me shume 90% te kompanive qe ofrojn sherbime te DDD qe te tendrojn:

Ne kemi analizuar dhe jane vetem 2(dy) Kompani qe posedojn kete ISO Standardene Republiken e Kosoves. Konsiderojme se eshte i panevojshem dhe nuk siguron ekzekutimin e sherbimeve ne perputhje me standardet e ligjet ne fuqi. Per faktin se te gjithë ata OE te cilaet jane te licencuar nga MPBZHR dhe nga MMPH jane n egjendje t ekryejn keto sherbime te DDD dhe kjo Certifikat EN 16636 2015 – Cepa certified eshte vetem kufizim i konkurrences dhe nuk garanton aspek AK per relizimin e natyres se sherbimeve te DDD-se. prandaj kerkojm qe kjo Certifikat te largohet s ebie ndesh me nenin 7 dhe 51 te LPP-se si dh eme nenin 64 dhe 69 te LPP-se.

Me fjalet jera, ne besojm se AK do te reflektoj dhe te veproj ne pajtim te plote me dispozitat ligjore qe e rregullojn keto çeshtje duke kërkuar AK te kthej ne rivlerësim dhe te na rekomandoj per dhenie te kontrates pasi qe ne kemi tenderuar me çmimin me te lire dhe te pergjegjshem, andaj AK – ZPP me rastin e rekomandimit per dhenie te kontrates per kete AP, eshte ne shklje te **nenit 7, 51, dhe 69 te LPP-se** dhe parimit kryesor te prokurimit: **“Vlera per para”**.

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u cekën me lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë ne harmoni me **nenin 7 dhe 51 LPP-së** dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie te kontratës, e qe ka qene tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet, sipas **nenit 69 dhe 70 te LPP-së**.

Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-së e parasheh qarte qe “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontrate.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsideratë edhe **nenin 1 te LPP-së**, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe

me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktues ne Kosoves.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga ESH – PSH që të shqyrtoj Ankesne tonë duke marr per baze konsistencen e vendime per kete natyre te sherbimeve ku per DDD eshte nxjerr vendim nga PSH ku obligon AK te kerkoj Epidemiolog, Biolog apo/ose mjek veterinar dhe të nxjerr:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar Ankesa nga OE: **Bio Vet DDD SHPK**

ANULOHET, - njoftimi mbi DT dhe NJK dhe lënda te kthehet ne **përputhje me nenin 53.7**, - Autoriteti kontraktues qe te korrigjoj dhe plotësoj DT dhe nJK ne përputhje me nenin 7, 51 dhe 69 te LPP-se, konforme dispozitave te LPP-së. Duke aprovuar ne ploteni kërkesën tone me fakte dhe argumente te faktuar dhe dëshmuara.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne institucionet tjera kompetente, dhe do te kërkojmë llogari përmes rrugëve ligjore nga te gjithapalët qe kane marr pjesë nekëtë aktivitet te prokurimit

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet material janë te mëdha ne përgatitjen e këtij tenderi dhe KpR ne vlere: 350 Euro, Deme tjera materiale te shkaktuar jane shume te medhe per kete projekt pasi qe mund te mbesin pa keto te ardhe qe mund ti marrin me ekzekutimin e ketij projekti -Kontrate, jane 3 – 5 % e fitimit te humbur nga ky projekt pasi qe jemi OE i pergjeshem ne kete AP.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*

- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.